



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2022/2 prot

Datë 23.07.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK me NIPT (J61901094G) & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK me NIPT (L61411012R) dhe adresë: Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89, Shk.A, Kati 10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga Dibrës, Nr. 372, Tiranë

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokollit 2022/2024, datë 22.07.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)”

SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-07795-06-03-2024, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor për Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’*”, me fond limit 122,786,742.45 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “R & T” SHPK & “Intelligent Building Solution (I.B.S)” SHPK kundërshton me anë të ankesës nr. A/2024/4354, datë 22.07.2024 dhe nr. Protokolli 2022/2024, datë 22.07.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

-Bashkimi i Operatoreve ekonomik nuk plotëson të gjitha kërkesat e vecanat për kualifikim sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, Shtojca e 8 e DST, mbi disponimin e një punonjësi të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Për plotësimin e kësaj kërkesë vetëm antari i BOE operatori ekonomik “R & T” sh.p.k. ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se disponon këtë punonjës, me iniciale E. N., si dhe ka paraqitur Çertifikatën e Kualifikimit me kod kursi HS003, lëshuar nga shoqëria Re Born. sh.p.k. dhe kohëzgjatje 80 orë.

Referuar Çertifikatës së Kualifikimit paraqitur ne Sisitemin e Prokurimit Elektronik, kohëzgjatja e kursit nuk plotëson kushtin në dokumentat e tenderit sipas shkronjën b), të pikës 2.3.5 të KVK, që çertifikimi përkatës të jetë në përputhje me VKM-në nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier", ku në nenin 10 parashikohet se “Kursi I formimit për sigurinë dhe shëndetin në punë duhet të jetë me kohëzgjatje jo më pak 120 orë. :

Neni 10 VKM-në nr.312, date 05.05.2010

3. Përmbajtja dhe kohëzgjatja e kurseve për të cilat flitet në pikën 2 duhet të respektojnë të paktën kërkesat e pikës së mëposhtme 8.

8. Kurs formimi për sigurinë e punës në sektorin e ndërtimit:

a) Kohëzgjatja 120 orë.

b) Përmbajtja legjislacioni në fuqi për sa i përket fushës së sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës; sëmundje profesionale; statistikat mbi shkeljet e rregullave në kantiere; analizimi i rreziqeve; rregullat teknike dhe kriteret për organizimin e kantierëve dhe kryerjen e punëve në kushte sigurie (përdorimi i makinave, PMP-ve, skelave dhe ndërtimeve të përkohshme etj.); metodat për përpunimin e planeve të sigurisë dhe të koordinimi.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.07.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri